



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 281/6 prot.

Tiranë, më 10.7.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 754, datë 5.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Mishgjoni
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.6.2024, është njoftuar vendimi nr. 754, datë 5.4.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 1.7.2024, protokolluar me nr. 281/2 prot., është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një Komision prej tre vëzhguesish të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, datë 28.6.2024, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 754, datë 5.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni*,”² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- iii Ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 *AKSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.11.2017³, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni*”.

2.3 *KLJGJ*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, znj. Mirela Mishgjoni.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

³ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr.***, datë **.9.2023.

⁴ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **.2.2023.

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...]Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën Vetting pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës [...].

3.2 **Për kontrollin e figurës.** [...]Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar [...].

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...]Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. **Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, me shumicë votash⁵, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.*

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁶ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁷ e ligjit nr. 84/2016, një Komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 1.7.2024, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. 281/2 prot., aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 754, datë 5.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni (bashkëlidhur dhe pjesë e këtij ankimi).

5.1 ONM, në mënyrë të përmbledhur, referon se disa çështje nuk janë vlerësuar si duhet nga Komisioni. Vendimi nuk duket të jetë tërësisht i bazuar në provat e administruara dhe në përputhje me standardet e mbajtura nga Komisioni në praktikën e tij si dhe nga parimet dhe udhëzimet e vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, në lidhje me disa gjetje të rëndësishme, që rezultuan nga hetimi. Për më tepër, vërehet që përpjekjet e subjektit të

⁵ Kundër, Kryesuese-Xhensila Pine.

⁶ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁷ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

rivlerësimin për të kundërshtuar këto gjetje, janë kryesisht të bazuara në shpjegime dhe nuk mbështeten në akte provuese.

5.2 Sa më sipër, ONM-ja çmon se një vlerësim i drejtë i provave referuar kuadrit ligjor të zbatueshëm, do të çonte në një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimin, znj. Mirela Mishgjoni.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimin kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimin nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimin, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 754, datë 5.4.2024, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

10. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 754/2024 të Komisionit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

A. Kontrolli i pasurisë

11. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimin, objekti i hetimit dhe i vlerësimin të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimin duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit.

12. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave vjetore periodike dhe asaj Vetting, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në datë **.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezultojnë të deklaruara:

13. Apartament banimi me sip. 111.6 m², ndodhur Vlorë.

13.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 111.6 m², (sip. bruto 120.7 m²), ndodhur në lagjen “***”, Vlorë, blerë më 3.5.2006. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si restorator i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklarueses. Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese: 50%.*

13.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2009, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 120.7 m², ndodhur në lagje ***, Vlorë, blerë më **.5.2006. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si avokate dhe aktiviteti restorator i bashkëshortit. Vlera 60.000 euro. Pjesa takuese: 100%.*

13.3 ILDKPKI-ja⁸, lidhur me këtë pasuri dhe burimet e krijimit të saj, ndër të tjera, ka konstatuar: (i) *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të shumës 60.000 euro, e cila është përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 111.6 m² në Vlorë, në v.2006; (ii) Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat nga aktiviteti privat i b/shortit si shef kuzhine për periudhën 2005 - 2011 të deklaruara në vlerën 5.400.000 lekë; (iii) Është e paqartë mënyra e përfitimit të shumës rreth 135.000 euro nga shitja e shoqërisë ***, si dhe ka mungesë dokumentacioni pjesërisht për likuidimin e saj pasi ka paraqitur çeqe të firmosura në vitin 2004 vetëm për shumën rreth 11.086 euro, të cilat duhet të shlyhen gjatë periudhës 2008 – 2009; (iv) Është i paqartë burimi i krijimit të përdorur për shumën rreth 87.798 euro, për blerjen e shoqërisë *** ***, e ***, nga shoqëria *** dhe ka mungesë dokumentacioni për mënyrën e likuidimit të saj; (v) Është e paqartë pjesa takuese e aksioneve që shtetasit *** ***, dhe *** ***, kanë secili në shoqërisë *** ***, e *** ***, S.N.C., për të përcaktuar vlerën e investuar edhe atë të përfutur nga shumat e cituara si më sipër.*

13.4 Gjatë hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera, janë administruar: (i) Kontratë kapari nr. ***/**, datë **.5.2006, me palë shitëse të ardhshme shoqërinë “*** ***” sh.p.k., dhe palë blerëse të ardhshme Mirela Mishgjoni, me objekt blerjen e ardhshme të pasurisë apartament i tipit “***”, me sip. 120.7 m², i ndodhur në lagjen *** Vlorë, në shumën 60.000 euro. (ii) Kontratë shitblerje nr. ***/***/* datë **.10.2013, me palë shitëse shoqërinë “*** ***” sh.p.k., dhe palë blerëse Mirela Mishgjoni dhe *** ***, me objekt shitjen e pasurisë apartament nr. **/**+*-**, me sip.111.6 m², i ndodhur në z. k. *** Vlorë⁹.

⁸ Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni të ILDKPKI nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

⁹ Lidhur me pagesat e kryera janë administruar: (i) Mandat derdhje cash në Bankën *** datë **.12.2005, shuma 25.000 euro; (ii) Mandat derdhje cash në Bankën *** datë **.05.2006, shuma 10.000 euro; (iii) Mandat derdhje cash në Bankën *** datë **.08.2006, shuma 19.000 euro; (iv) Mandat arkëtimi nr. ** datë **.06.2007 paguar shuma 4.864 euro nga subjekti i rivlerësimit në arkën e shoqërisë *** ***, sh.p.k.

13.5 Në deklaratën “Vetting”, subjekti deklaroi si burim krijimi të pasurisë Apartament me sip. 111.6 m² “*Të ardhura nga aktiviteti si restorator i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklarueses.*”

13.6 Lidhur me të ardhurat nga avokatia të subjektit, nga hetimi ka rezultuar se në periudhën 2004 – janar 2006, subjekti i rivlerësimit, ka ushtruar profesionin e avokatit, por nuk rezultoi i regjistruar në organet tatimore dhe si rezultat në analizë të burimit të ligjshëm konform nenit D, pika 3 e Kushtetutës, Komisioni ka çmuar se të ardhurat e subjektit të deklaruar nga avokatia për periudhën 2004 – 2006, nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie. Për vitin 2007 është përfshirë në analizën e Komisionit vlera 2,388,160 lekë, e cila është llogaritja me 80% e marzhit të fitimit të vlerës së deklaruar nga subjekti dhe për të cilin janë shlyer detyrimet tatimore.

13.7 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga shitja e shoqërisë “****” S.N.C., Komisioni ka konsideruar se vetëm 50% e vlerës së shitjes ose rreth 65.800 euro është pjesa takuese e z. ****. Gjithsesi, në analizën financiare të Komisionit nuk janë përfshirë të ardhura nga shitja e aktivitetit të bashkëshortit në Itali, pasi subjekti nuk arriti të provojë shlyerjen e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, por u provua se shlyerja e tyre filloi vetëm gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit.

13.8 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga paga gjatë emigracionit në shtetin Italian, Komisioni ka kryer analizën financiare të bashkëshortit gjatë qëndrimit të tij në Itali duke përfshirë të ardhurat e vërtetuara nga INSP (Itali) për vitet 1996-1997 dhe 2005, me vërtetim të përcjellë nga subjekti. Ndërsa, për periudhën 1998-2004, janë konsideruar të ardhura të ligjshme ato të provuara nga Agjencia e Tatimeve, edhe pse referuar legjislacionit tatimor të shtetit italian, këto të ardhura nuk përfaqësojnë saktësisht të ardhurën neto të marrë prej tij. Shpenzimet jetike janë përfshirë në referencë me të dhënat e Eurostat për një anëtar të familjes duke konsideruar aktivitetin e kryer prej bashkëshortit pranë restoranteve, i cili mund të ketë ndikuar në reduktimin e këtyre shpenzimeve. Nga analiza rezultoi se bashkëshorti ka pasur mundësi të kursejë vlerën 36,185 euro për periudhën 1996-maj 2005.

13.9 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga akt marrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, Vlorë, Komisioni ka vlerësuar të mos i përfshijë në analizë këto të ardhura, për shkak se nuk u provua shlyerja e detyrimeve tatimore për këtë shumë të ardhurash.

13.10 Në vijim, Komisioni ka hartuar analizën financiare për periudhën 2005 – 2007¹⁰, për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pagesave të apartamentit, nga ku ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur pamundësi në kryerjen e pagesave të apartamentit me të ardhura të ligjshme në vlerën -3.626.738 lekë.

13.11 Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se: (i) *Duket se subjekti dhe shtetasi **** kanë pasur pamundësi për krijimin e vlerës së blerjes së apartamentit me të ardhura të ligjshme, në shumën -3.626.738 lekë.* (ii) *Duket se apartamenti është blerë nga subjekti dhe shtetasi ****, përpara lidhjes së martesës ligjore të tyre dhe gjatë kohës që subjekti*

¹⁰ Komisioni llogaritjet i ka filluar në vitin 2005 pasi pagesa e parë e kryer nga subjekti për apartamentin është kryer në këtë vit, por gjithashtu nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar kursime *cash* në DV 2003-2004 me burim të ardhur nga periudha të mëparshme.

ushtronte profesionin e avokatit. Në vijim, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit¹¹.

13.12 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, ka pretenduar përfshirjen e të ardhurave të trajtuara më sipër në këtë ankim¹².

13.13 Komisioni, në përfundim, ndër të tjera ka arsyetuar:

(1) Lidhur me të ardhurat e subjektit nga avokatia [...] Lidhur me të ardhurat për periudhën 2007 – 2009, Komisioni vlerësoi të përfshijë të ardhurat neto të llogaritura me marzhin e fitimit 90%, duke u mbështetur në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit mbi të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë. Komisioni çmon se e ardhura totale që duhet të përfshihet në analizën financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë prej subjektit është vlera 4,876,680 lekë¹³.

(2) Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur nga shitja e shoqërisë “***” S.N.C [...] Trupi gjykues çmon se në rastin konkret këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Por, pavarësisht kësaj, në analizë të vlerësimit të mësipërm, në mungesë të keqbesimit të bashkëshortit, kohës së gjatë të krijimit të këtyre të ardhurave, para lidhjes së martesës, si dhe mungesës së keqbesimit nga ana e subjektit, pavarësisht se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues çmon se duhet të vlerësohen jopenalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së këtyre të ardhurave. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit¹⁴ [...].

(3) Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur nga akt-marrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, Vlorë [...] Trupi gjykues çmon se në rastin konkret këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Por, pavarësisht kësaj, në analizë të vlerësimit të mësipërm, kohës së gjatë të krijimit të këtyre të ardhurave, krijimit para lidhjes së martesës, si dhe mungesës së keqbesimit nga ana e subjektit, pavarësisht se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues çmon se duhet të vlerësohen se nuk mund të jetë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së këtyre të ardhurave. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit¹⁵ [...].

(4) Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar [...] Komisioni çmon se në vlerësimin e tij lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi janë krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, janë të ardhura të provuara nëpërmjet akteve noteriale, nuk janë produkt i një veprimtarie të paligjshme, si dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të

¹¹ Referohuni rezultateve të hetimit administrative f. 12.

¹² Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësimet e datës 27.3.2024.

¹³ Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 8 e vendimit.

¹⁴ Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 12 e vendimit.

¹⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 14 e vendimit.

përdorimit të të ardhurave, për të cilat nuk ishin shlyer detyrimet tatimore. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë [...].

13.14 Komisioni, në vlerësim përfundimtar për kriterin e pasurisë, ndër të tjera, ka arsytuar se: [...] *Bazuar edhe në parimin e objektivitetit, i cili parashikohet nga neni 14 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”, Komisioni vlerësoi se të gjitha rrethanat, në mënyrë thelbësore lidhen me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në Itali dhe shitjen e një aktiviteti në vitin 2004 ... trupi gjyqës çmon se pasuria e deklaruar ka si burim të ardhurat e bashkëshortit, të krijuara kohë më parë se ata të fillonin bashkëjetesën ligjore. Këto të ardhura rezultojnë nga burime të ligjshme, të dokumentuara me akte juridike dhe transaksione bankare, ku i vetmi element që nuk përmbush kushtet e nenit D, pika 3, është pagesa e tatimeve gjatë procesit të rivlerësimit. Kjo situatë faktike nuk është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt, i cili të prodhojë pasoja për subjektin e rivlerësimit, vendosjen e masës së shkarkimit të tij nga detyra. ... Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se mungesa e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga shitja në vitin 2004 të shoqërisë “***”, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016¹⁶ [...].*

13.15 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit lidhur me pasurinë “apartament me sip.111.6 m²”, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vëren se:

13.15.1 Fillimisht, lidhur me konstatimin e Komisionit, se duket se apartamenti është blerë nga subjekti dhe shtetasi *** ** përpara lidhjes së martesës ligjore të tyre dhe gjatë kohës që subjekti ushtronte profesionin e avokatit, rezultojnë rrethanat si vijojnë:

(1) Subjekti i rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni, në periudhën 1995-2002, ka punuar si ndihmës gjyqtare dhe gjyqtare. Në datë **.7.2002, me vendim nr.***, është shkarkuar nga detyra nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendim nr.* datë **.2.2009, kanë vendosur shfuqizimin e vendimit nr.***/* të KLD-së, dhe në datë **.2.2009, subjekti ka filluar sërish punë si Gjyqtare.

(2) Në Deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të depozituar në ILDKPKI në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pjesë takuese lidhur me këtë pasuri përkatësisht në masën 50% dhe 100%.

(3) Në kontratën e kaparit, datë **.5.2006, dhe në kontratën e shitblerjes, datë **.10.2013, subjekti i rivlerësimit, ka nënshkruar në cilësinë e palës blerëse/blerëse të ardhshme për pasurinë apartament me sip.111.6 m², të ndodhur në Vlorë, në vlerën 60.000 euro.

13.15.2 Gjatë hetimit janë administruar mandatpagesat për shlyerjen e kësaj pasurie për periudhën **.12.2005- **.6.2007, të cilat rezultojnë të nënshkruara nga subjekti i

¹⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 34-36 të vendimit.

rivlerësimit, ku një nga këto mandate, konkretisht mandati në shumën 25.000 euro, rezulton se daton në **.12.2005, pra rreth 3 muaj përpara nënshkrimit të kontratës së kaparit.

(4) Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se ka filluar bashkëjetesën me z. *** ***, duke filluar nga viti 2005.

13.15.3 Në këto rrethana, ndryshe nga sa konstaton Komisioni, rezulton se znj. Mirela Mishgjoni, ka mbajtur funksionin e gjyqtares për disa vite përpara blerjes së kësaj pasurie, dhe megjithëse subjekti ka lidhur martesë ligjore në vitin 2008, ajo ka bashkëjetuar me z. *** ***, që prej vitit 2005, si dhe ka nënshkruar kontratat për këtë pasuri si dhe të gjitha mandatpagesat respektive.

13.15.4 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 111.6 m², Komisioneri Publik, çmon se subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me pamundësinë financiare për kryerjen e pagesave të apartamentit, për sa trajtuar në vijim.

13.15.5 Lidhur me të ardhurat e z. *** ***, nga shitja e shoqërisë “****” S.N.C në Itali, çmohet se Komisioni në mënyrë të gabuar ka marrë në konsideratë në vlerësim tërësor të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj shoqërie, ndërkohë që rezulton se shlyerja e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura ka nisur nga data **.11.2023, kur për subjektin kishte filluar procesi i rivlerësimit. Pra duket se detyrimet tatimore kanë nisur të paguhesh me vonesë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit, dhe si të tilla nuk duhet të përfshihen në analizën financiare.

13.15.6 Sa i takon të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në Itali, rezulton se të ardhurat e llogaritura nga Komisioni, janë në vlerën 67.319 euro, që përveçse sikurse dhe vetë Komisioni ka arsyetuar, nuk përfaqësojnë të ardhurën neto, janë të ndryshme dhe nga të ardhurat e bashkëshortit sipas vërtetimit të INSP-në, që rezultojnë në vlerën 36.822 euro¹⁷.

13.15.7 Gjithashtu, vërejmë se shpenzimet e jetesës për personin e lidhur në shtetin Italian për këto vite, nuk janë llogaritur me të njëjtin standard që Komisioni ka llogaritur shpenzimet e jetesës për personin tjetër të lidhur shtetasin ***.***. Nëse shpenzimet e jetesës të personit të lidhur do të llogariteshin sipas të dhënave të Eurostat, sikurse janë llogaritur dhe për kunatin e subjektit, atëherë shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë 1996-2005, do të rezultonin në vlerën rreth 57.000 euro¹⁸. Në vijim, duke konsideruar dhe shpenzimet/investimet e kryera për shoqërinë “****” S.N.C nuk do të rezultonte mundësi kursimi nga të ardhurat e personit të lidhur nga punësimi në Itali.

13.15.8 *Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti rristorator gjatë periudhës 2005 – 2011, deklaruar në Deklaratën “Vetting”, në shumën rreth 5.400.000 lekë (për të gjithë periudhën), nuk u administrua asnjë akt i kohës që të provojë përfitimin e këtyre shumave, kohën e përfitimit dhe shumën përkatëse. Komisioneri Publik, vlerëson se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare, dhe në konsideratë të qëndrimit*

¹⁷ Referohuni analizës financiare të Komisionit në tabelën nr. 5, f. 10 e rezultateve të hetimit.

¹⁸ Referohuni analizën financiare të Komisionit të administruar në dosjen hetimore, zërit *Shpenzimet jetike eurostat 60% threshold*.

orientues të Kolegjit¹⁹, se pagimi i detyrimeve tatimore nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera.

13.15.9 Lidhur me pretendimin e subjektit, se bashkëshorti ka ardhur në dijeni vetëm gjatë procesit, për mosshlyerjen e detyrimeve tatimore dhe ka kërkuar gjyqësisht që punëdhënësit të zbatojnë detyrimet ligjore, sjellim në vëmendje se Kolegji ka trajtuar në jurisprudencën e tij, situata të ngjashme²⁰, ku përpjekja për të arritur te pagesa e detyrimeve tatimore, gjatë procesit, është vlerësuar se përfaqëson veprime të kryera për efekt të këtij procesi.

13.15.10 Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga akt – marrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit Vlorë, çmujmë se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare dhe nuk duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor, pasi përveçse nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratat periodike vjetore si të ardhura apo si burim krijimi, nuk plotësojnë dhe kriteret e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

13.15.11 Përveç sa më sipër, rezulton se të ardhurat nga aktiviteti si ristorator i bashkëshortit dhe nga aktiviteti si avokate i subjektit, janë deklaruar si burim krijimi jo vetëm për blerjen e pasurisë apartament në vlerën 60.000 euro, por dhe si burime krijimi të pasurive: (i) Depozitë bankare në bankës ***, krijuar në datën *.6.2008, në vlerën 1.013.500 lekë; (ii) Autoveture tip “Daimler Chrysler”, blerë në datën *.1.2008, në shumën 500.000 lekë; (iii) Huadhënien në shumën 17.000 euro dhënë motrës së subjektit në vitin 2008; (iv) Kursime në shumën 70.000 euro; (v) Huadhënie shtetasit ***.***., në shumën 3.000.000 lekë²¹.

13.15.12 Në përfundim, *Komisioneri Publik*, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 28.6.2024, vlerëson se, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 111.6 m², Vlorë, duke u gjendur në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

14. Tokë bujqësore, deklaruar nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit z. *. ***.**

14.1 Në D-Vett., personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se zotëron tokë bujqësore në total me sipërfaqe rreth 15.560 m², në ***, Vlorë, konkretisht:

14.2 (I) *Tokë bujqësore, sip. 4.560 m², në *** Vlorë, blerë me kontratën nr. ***/*** datë **.4.2012. Burimi i krijimit: Kursime. Vlera 273.600 lekë, pjesa takuese 100%.*

14.2.1 ILKDPKI-ja²², lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: *Dyshohet vlerë e ulët e blerjes së tokës me sip.4.560 m² në *** Vlorë, blerë në v.2012 në shumën 273.600 lekë, pasi çmimi i referencës së tokës referuar kontratës së shitblerjes është në shumën 1.894.756 lekë.*

¹⁹ Referuar Vendimit (JR) të Kolegjit nr. 15/2021.

²⁰ Referuar Vendimit (JR) të Kolegjit nr. 23/2020.

²¹ Referohuni deklarameve të subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës dorëzuar në ILKDPKI në vitin 2009.Në deklaratën para fillimit të detyrës është deklaruar vetëm huadhënie në emër të shtetasit ***.***., pa deklaruar shumën ndërsa gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nga kursimet e *** ** shtetasit *** ** dhe *** ** kanë përdorur shumën 3.000.000 lekë dhe se me lidhjen e martesës bashkëshorti ka kërkuar kthimin e kësaj shume.

²² Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni të ILKDPKI-së nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

14.2.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ,²³ rezulton se: (i) Me kontratë shitblerje nr. ***/** kol., datë **.4.2012, bashkëshorti i subjektit ka blerë nga shtetasit *** dhe *** (përfaqësuar nga shtetasi *** ***) pasurinë me nr. ***/*, e llojit tokë arë me sip. 4.560 m², ndodhur në z. k. ***, ***, Vlorë.

14.2.3 Në kontratë citohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë 1.894.756 lekë, (çmim nga rivlerësimi për efekt tatimi) dhe se pala blerëse në marrëveshje të plotë me palën shitëse e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë në shumën 273.600 lekë, shumë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale. Nga kartela e pasurisë konstatohet se pasuria është rivlerësuar në datë **.2.2012, në vlerën 1.894.756 lekë.

14.2.4 Me prokurë të posaçme nr. ***/**/* datë **.12.2010, shitësit *** dhe *** emërojnë si përfaqësues të posaçëm ligjor z. *** ** (kunati i subjektit të rivlerësimit), ndër të tjera, për shitjen e pasurisë me sipërfaqe 4.560 m². Në këtë prokurë shitësit deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë objekt kontrate pasi kanë marrë prej z. *** ** vlerën e shitjes (shuma nuk specifikohet).

14.3 (2) Tokë bujqësore, sip. 4.300 m², në *** Vlorë, blerë me kontratën nr. ***/** datë **.4.2012. Burimi i krijimit: Kursime. Vlera 258.000 lekë, pjesa takuese 100%.

14.3.1 ILDKPKI-ja²⁴ lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: *Dyshohet vlerë e ulët e blerjes së tokës me sip.4.300 m² në *** Vlorë, blerë në v.2012 në shumën 258.000 lekë, pasi çmimi i referencës së tokës referuar kontratës së shitblerjes është në shumën 1.748.380 lekë.*

14.3.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ²⁵ rezulton se: (i) Me kontratë shitblerje nr. ***/** kol., datë **.4.2012, bashkëshorti i subjektit ka blerë nga shtetasit ***, ***, dhe ***, ***, përfaqësuar nga shtetasi *** ***, pasurinë tokë arë me nr. ***/*, dhe sip. 4.300 m², e ndodhur në z. k. ***, ***, Vlorë.

14.3.3 Në kontratë palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë 1.748.380 lekë, (çmim nga rivlerësimi për efekt tatimi) dhe se pala blerëse në marrëveshje të plotë me palën shitëse e ka blerë këtë sipërfaqe tokë arë në shumën 258.000 lekë, shumë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale. Nga kartela e pasurisë konstatohet se pasuria është rivlerësuar në datë **.2.2012 në vlerën 1.748.380 lekë.

14.3.4 Me prokurën e posaçme nr. ***/** datë **.1.2011, shitësit emërojnë si përfaqësues të posaçëm ligjor z. *** **, për shitjen e pasurisë me sipërfaqe 4.300 m². Në këtë prokurë familja ***, deklaron se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë objekt kontrate pasi kanë marrë prej z. *** ** edhe vlerën e shitjes për sipërfaqen prej 4.300 m² (shuma nuk specifikohet).

14.4 Tokë bujqësore, sip. 1.000 m², në *** Vlorë, blerë me kontratën nr. ***/** datë **.3.2010. Burimi i krijimit: Me të ardhura të kursyera. Vlera 60.000 lekë, pjesa takuese 100%.

²³ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së ZVRPP Vlorë nr. ***/* prot., datë **.9.2017.

²⁴ Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni të ILDKPKI-së nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

²⁵ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së ZVRPP Vlorë nr. ***/* prot., datë **.9.2017.

14.4.1 ILKDPKI-ja²⁶ lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: *Dyshohet vlerë e ulët e blerjes së tokës me sip. 1.000 m² në *** Vlorë, blerë në v.2010 në shumën 60.000 lekë, pasi çmimi i referencës së tokës referuar kontratës së shitblerjes është në shumën 406.600 lekë.*

14.4.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ²⁷, rezulton se: (i) Me kontratë shitblerje nr. ***/*** datë **.3.2010, bashkëshorti i subjektit ka blerë nga shtetasit ***, ***, dhe ***. *** (përfaqësuar nga shtetasi *** ***) pasurinë tokë arë me nr. ***/***, me sip. 1.000 m², e ndodhur në z. k. ***, ***, Vlorë. Në kontratë citohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke vetëm për efekt tatimi të jetë 406.600 lekë dhe se pala blerëse e ka blerë këtë sipërfaqe toke arë në shumën 60.000 lekë; (ii) Me prokurën e posaçme nr. ***/*** datë **.10.2009 shitësit emërojnë si përfaqësues të posaçëm ligjor z. *** *** për shitjen e pasurisë me sipërfaqe 1.000 m². Në këtë prokurë ***, ***, dhe ***. *** deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë objekt kontrate, pasi kanë marrë prej z. *** *** edhe vlerën e shitjes për sipërfaqen prej 1.000 m² (shuma nuk specifikohet).

14.5 (3) *Tokë bujqësore sip. 3.200 m², në *** Vlorë, blerë me kontratën nr. ***/*** datë **.3.2010. Burimi i krijimit: me të ardhura të kursyera. Vlera 320.000 lekë, pjesa takuese 100%.*

14.5.1 ILKDPKI-ja²⁸ lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: *Dyshohet vlerë e ulët e blerjes së tokës me sip. 3.200 m² në *** Vlorë, blerë në v.2010 në shumën 320.000 lekë, pasi çmimi i referencës së tokës referuar kontratës së shitblerjes është në shumën 1.301.120 lekë.*

14.5.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ²⁹, rezulton se: (i) Me kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.3.2010, bashkëshorti i subjektit ka blerë nga shtetasit *** (përfaqësuar nga shtetasi *** ***) pasurinë tokë arë me nr. ***/***, me sip. 3.200 m², e ndodhur në z. k. ***, ***, Vlorë.

14.5.3 Në kontratë citohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë vetëm për efekt tatimi të jetë 1.301.120 lekë dhe se pala blerëse e ka blerë këtë sipërfaqe toke arë me vlerën 320.000 lekë.

14.5.4 Me prokurat e posaçme nr. ***/***, ***/*** dhe ***/***, datë **.3.2010 shitësit emërojnë si përfaqësues të posaçëm ligjor z. *** *** për shitjen e pasurisë me sipërfaqe 3.200 m² si dhe deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë objekt kontrate pasi kanë marrë prej z. *** *** edhe vlerën e shitjes për sipërfaqen prej 3.200 m² (shuma nuk specifikohet).

14.5.5 Në prokurën nr. ***/***, citohet se për çdo veprim që lidhet me sa më sipër, përfaqësuesi ligjor ka të drejtë, ndër të tjera, të ndjekë në vazhdimësi regjistrimin e pasurisë në emrin e blerësit të ardhshëm z. *** ***.

²⁶ Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni të ILKDPKI-së nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

²⁷ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së ZVRPP Vlorë nr. ***/** prot., datë **.9.2017.

²⁸ Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni të ILKDPKI-së nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

²⁹ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së ZVRPP Vlorë nr. ***/** prot., datë **.9.2017.

14.6(4) *Tokë bujqësore sip. 2.500 m², në *** Vlorë, blerë me kontratën nr. ***/*** datë **3.2010. Burimi i krijimit: me të ardhura të kursyera. Vlera 150.000 lekë, pjesa takuese 100%.*

14.6.1 ILDKPKI-ja³⁰, lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: *Dyshohet vlerë e ulët e blerjes së tokës me sip. 2.500 m² në *** Vlorë, blerë në v.2010 në shumën 150.000 lekë, pasi çmimi i referencës së tokës referuar kontratës së shitblerjes është në shumën 1.016.500 lekë.*

14.6.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ³¹, rezulton se: (i) Me kontratë shitblerje nr. ***/***/* datë **3.2010, bashkëshorti i subjektit ka blerë nga familja *** (përfaqësuar nga shtetasi *** ***) pasurinë tokë arë me nr. ***/***, me sip. 2.500 m², e ndodhur në z. k. ***, ***, Vlorë.

14.6.3 Në kontratë citohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqe toke arë të jetë vetëm për efekt tatimi 1.016.500 lekë dhe se pala blerëse e ka blerë këtë sipërfaqe toke arë në shumën 150.000 lekë.

14.6.4 Me prokurën e posaçme nr. ***/*** datë **.10.2009, shitësit emërojnë si përfaqësues të posaçëm ligjor z. *** *** për shitjen e pasurisë me sipërfaqe 2.500 m². Në këtë prokurë familja *** deklaroi se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë objekt kontrate pasi kanë marrë prej z. *** *** edhe vlerën e shitjes për sipërfaqen prej 2.500 m² (vlera e shitjes nuk specifikohet).

14.7 Komisioni, në pyetësin nr.3, ndër të tjera, i ka kërkuar informacion subjektit në lidhje me (1) sa ka paguar bashkëshorti i motrës për blerjen e këtyre pasurive; (2) për çfarë përdoren këto toka, si dhe (3) nëse subjekti ka gjykuar shitësit e këtyre tokave bujqësore duke vënë në dispozicion dhe dokumentacion provues.

14.8 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se : [...] *Bashkëshorti i motrës time është vënë në dijeni nga një mik i tij se banorë të fshatit *** shisnin prona me çmim 50 lekë/m², për shkak se ishin toka bujqësore të paregjistruara dhe me vendndodhje me një distancë të konsiderueshme nga rruga kryesore dhe totalisht e painvestuar. ...Duke qenë se shtetasi *** *** kishte qëllim ushtrimin e një aktiviteti tregtar i kërkoi bashkëshortit tim ndihmë për regjistrimin e tyre dhe asistencë. Në këto kushte bashkëshorti e informoi se në prokurën që do të lëshohej nga pronarët e tokave, të cilët i kishin përfituar me AMTP, të vendosej edhe fakti që shtetasi *** *** i kishte likuiduar, me qëllim që në vijim të mos bëhej ndonjë veprim për revokimin e prokurës nga ana e tyre dhe investimi i tij të shkonte dëm. Bashkëshorti i motrës time për shkak të mos sigurimit të mjeteve të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit tregtar që mendonte të kryente, i propozoi bashkëshortit blerjen e këtyre tokave bujqësore me një çmim 60 lekë/m² (ndërsa për tokën me sipërfaqe 3200 m² me çmim 100 lekë/m²), për sa kohë që edhe e kishte ndihmuar. Në lidhje me këtë çmim ai vuri si kusht dhe pagimin e të gjitha detyrimeve tatimore por edhe ato të regjistrimit. Pikërisht për këtë fakt të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga bashkëshorti im... Rezulton se vlera e blerjes të secilës*

³⁰ Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni të ILDKPKI-së nr. ***/***/* prot., datë **3.2021.

³¹ Referohuni akteve bashkëlidhur shkresës së ZVRPP Vlorë nr. ***/***/* prot., datë **.9.2017.

prej këtyre pasurive është ajo e përcaktuar në kontratë, dhe jo çmimi i përmendur për efekt tatimi [...].

14.9 Lidhur me përdorimin e këtyre tokave, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ndër të tjera, ka deklaruar se : [...] Tokat me sipërfaqe 1000 m², 2500 m² dhe 3200 m², i janë dhënë në përdorim pa pagesë me qëllim krijimin e një vreshti shtetasit *** ***, në marrëdhënie shoqërore me bashkëshortin, i cili është i regjistruar si person fizik “*** **”, me nipt ***, me objekt të ushtrimit të aktivitetit “Prodhim, riprodhim dhe shumëzim të materialeve mbjellëse bimore (fidanë hardhie). Prodhim dhe tregtim me pakicë të verës dhe rakisë”. Mbjellja me hardhi e sipërfaqeve 1000 m², 2500 m² dhe 3200 m², që i janë dhënë në përdorim shtetasit *** ***, shërbimet, vjelja dhe përpunimi i prodhimit kryhen nga ky shtetas, i cili sipas marrëveshjes me bashkëshortin i jep 10% të verës që prodhohet³². [...]

14.10 Në lidhje me konfliktin e interesit³³ me shitësit e këtyre tokave bujqësore, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] me vendimin nr.***, datë **.12.2018, ka gjykuar kërkesën e shtetasit *** *** kundër shtetasit *** (***) ***, me objekt: Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në datën **.11.2018, datë në të cilën më është caktuar kjo çështje për gjykim, ka deklaruar dorëheqjen, dorëheqje e cila me vendimin datë **.11.2018, nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës ... Me vendimin nr.***, datë **.12.2021, ka gjykuar kërkesën e Shoqërisë “*** ** **”, sh.p.k., me objekt: Lëshim Urdhër Ekzekutimi, për kontratë kredie bankare nr.****, datë **.12.2018, të lidhur ndërmjet shoqërisë “*** **”, sh.p.k. dhe shtetasit *** **. Menjëherë sa i është caktuar kjo çështje për gjykim, ka deklaruar dorëheqjen, dorëheqje e cila me vendimin datë **.12.2021, nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës [...].

14.11 Komisioni, për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pasurive tokë bujqësore, ka kryer analizën financiare duke përfshirë në çmimin e blerjes së këtyre pasurive sikundër është përcaktuar nga palët në kontratat respektive të shitblerjes, nga ku ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur, kanë pasur mundësi të blejnë me të ardhura të ligjshme pasuritë e sipërcituara.

14.12 Gjithashtu, Komisioni, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të jap shpjegime lidhet me faktet e konstatuara se: (i) Në kërkesën për dorëheqje të subjektit në lidhje me shtetasin *** *** ajo nuk ka parashtruar faktin se bashkëshorti i saj kishte lidhur kontratë shitblerje me këtë shtetas. (ii) Subjekti të japë shpjegime në lidhje me çmimin e blerjes së parcelave të tokave të ndodhura në ***, Vlorë, pasi nga dokumentacioni i përcjellë rezultojnë çmime të ndryshme për të njëjtën pasuri.

³² Bashkëlidhur pyetësorit subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr.***/****, datë **.7.2023, të PF “*** **” i cili ndër të tjera deklaroi se z. *** *** tokat e sipërcituara të cilat janë në total 6700 m² ia jepte në përdorim dhe në çdo sezon të vjeljes së rrushit e prodhimit të verës në mirëbesim i jepte atij 10% të gjithë sasisë së verës që mesatarisht i ka dhënë 100 litra.

³³ Subjekti ka depozituar: (i) Vërtetimin nr.***, datë **.7.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; (ii) Vendimi nr.***, datë **.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së bashku me dosjen gjyqësore pjesë e të cilës janë dhe Kërkesa për dorëheqje datë **.11.2018; (iii) Vendimi datë **.11.2018, i Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për mospranimin e kërkesës për dorëheqje; (iv) Vendimi nr. ***, datë **.12.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së bashku me dosjen gjyqësore pjesë e të cilës janë dhe Kërkesa për dorëheqje datë **.11.2021; (v) Vendimi datë **.12.2021, i Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për mospranimin e kërkesës për dorëheqje.

14.13 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegime dhe ka deklaruar se vlera e blerjes të secilës prej pasurive të sipërcituara është ajo e përcaktuar në kontratë dhe jo çmimi i përmendur për efekt tatimi. Po kështu ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit apo të fshehjes së pasurisë³⁴.

14.14 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se: [...] *nuk lindin dyshime lidhur me çmimin e parashikuar në kontratën e shitjes, i cili rezulton më i ulët se ai i referencës. Së pari, nga hetimi nuk rezultuan indicie për konflikt interesi me shitësit e tokave. Së dyti, çmimi i referencës është vendosur si një çmim për efekt llogaritjeje tatimi, e provuar kjo si një praktikë e noteres. Së treti, ekzistenca e kunatit të subjektit si përfaqësues i pronarëve të tokës nuk mund të jetë një element që të çon në një deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, mbi të cilin mund të ngrihen dyshime për vlerën reale të saj. Kunati ka marrë prokurat respektive kohë më parë se të lidheshin kontratat e shitjes, me përjashtim të njëres prej tyre. Kjo pronë ka qenë e pazhvilluar, e paregjistruar dhe nuk ka asnjë indicie që vlera reale e këtyre pronave nuk ka qenë sa ajo e shitjes, por ka qenë sa ajo e referencës fiskale apo edhe më shumë se referenca fiskale. Parashikimi i çmimit është dhënë në një kontratë, ku fuqia ligjore e saj është e bazuar ligjërisht dhe nuk mund të vihet në diskutim si e tillë. Lidhur me konfliktin e interesit, shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe mosdeklarimi i shkakut të dorëheqjes nuk përbën fshehje, pasi fakti nuk përbën një nga shkaqet për dorëheqje, duke pasur gjithashtu parasysh që vendimmarrja është shumë kohë më pas lidhjes së kontratës së shitjes ... këto pasuri janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e tyre [...].*

14.15 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit lidhur me pasuritë tokë bujqësore “Arë” të trajtuara më sipër, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni për sa vijon.

14.15.1 Në të gjitha kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive të paluajtshme, janë përcaktuar dy vlera, vlera e çmimit të referencës dhe vlera e blerjes/çmimi, i paguar nga bashkëshorti i subjektit. Vlera totale e pasurive tokë bujqësore “Arë”, sipas çmimit minimal të referencës fiskale, (mbi të cilin do të paguheshin tatimet) llogaritet në vlerën 6.367.356 lekë, ndërsa rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka blerë këto pasuri në shumën 1.061.600 lekë, që është një çmim disa herë më i ulët se çmimi i referencës.

14.15.2 Në të gjitha kontratat e shitblerjes, shitësit e këtyre pasurive të paluajtshme janë përfaqësuar nga bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit, z. ***, ***. Ky i fundit me cilësinë e përfaqësuesit të palës shitëse, i ka shitur këto pasuri tek bashkëshorti i subjektit, disa prej të cilave vetëm disa ditë më pas nga data e aktit të përfaqësimit/prokurës së posaçme, me palën shitëse.

14.15.3 Në prokurat e lëshuara me përfaqësues ligjor z. *** ***, specifikohet se shitësit kanë marrë vlerën e shitjes, por kjo vlerë nuk është referuar në dokument. Mbetet e paqartë sesi janë kryer këto transaksione, sepse nuk ka asnjë akt që të provojnë këto pagesa. Komisioni nuk ka administruar asnjë akt për të provuar çmimin real të shitjes së tokave bujqësore tek z.

³⁴ Për më tepër referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 27.3.2024.

*** ***, i cili më vonë ia shiti bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, nuk duket të ketë administruar informacion nga ASHK-ja për të verifikuar vlerën e këtyre pasurive pas shitjes.

14.15.4 Komisioni, lidhur me përdorimin e këtyre pasurive, është mjaftuar me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, ku në përgjigje të pyetësorit nr.3, ka deklaruar se në tokat me sip. 4560 m² dhe 4300 m², nuk ka ndërtime apo investime, ndërsa për tre nga pasuritë e tjera, ka deklaruar se i janë dhënë në përdorim, pa pagesë, shtetasit ***.***., i cili sipas marrëveshjes me bashkëshortin e subjektit i jep 10% të verës që prodhohet. Në dosjen e Komisionit, nuk gjenden të administruara akte në drejtim të verifikimit të deklaratimeve të subjektit, nëse ka një marrëveshje biznesi të shkruar me z. ***.***., apo nëse në tokat e blera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është zhvilluar vreshtari, duke mbetur pretendimet e subjektit, vetëm në nivel deklarativ.

14.15.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” dhe në deklaratat periodike vjetore, ekzistencën e kësaj marrëdhënie të përdorimit të pasurive nga shtetasi ***.***., në formën e një interesi privat. Po ashtu nuk rezulton të jenë deklaruar shpenzime/investime apo të ardhura të realizuara lidhur me këto pasuri, ndërkohë që referuar deklaratimeve të vetë subjektit, duket se janë krijuar të ardhura, më së paku, në natyrë, për subjektin dhe personin e lidhur.

14.15.6 *Komisioneri Publik*, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni³⁵, si dhe bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vëren se nëse në analizën financiare të viteve kur janë blerë këto pasuri, do të përfshihej si investim çmimi i referencës i cituar në kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur do të rezultonin me mungesë burimesh të ligjshme për vitet 2010 dhe 2012³⁶ dhe si pasojë konkluzioni në lidhje me këto pasuri do të ishte i ndryshëm.

14.15.7 *Komisioneri Publik*, lidhur me konfliktin e interesit, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk janë bindëse, pasi mosreferimi në kërkesën e dorëheqjes të rrethanave të plota, lidhur me marrëdhënien me karakter pasuror mes shitësve të pasurive dhe bashkëshortit të saj, më së paku, pamundëson vlerësimin e drejtë të titullarit, mbi situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

14.15.8 Nga përmbajtja e kërkesës për dorëheqje e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i çështjes civile me nr.*** regj. themeltar, datë **.11.2018, që i përket shtetasve ***.***, si paditës dhe ***.***, e paditur, me objekt “Lëshim urdhër mbrojtje”, konstatohet se arsyeja e vetme e heqjes dorë nga subjekti është *se çështja nuk duhet të gjykohet nga ana e saj (seksioni familjar), por duhet të gjykohet nga të gjithë gjyqtarët e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe duhet t’i nënshtrohen shortit elektronik dhe nuk rezulton të ketë parashtruar si shkak marrëdhënien kontraktuale të bashkëshortit*³⁷.

³⁵ Referohuni analizën financiare në f. 37 të vendimit të Komisionit.

³⁶ Referuar Rekomandimit të ONM-së, f. 6, pamjaftueshmëria rezulton në vlerën -235.435 lekë për vitin 2010 dhe -3.001.912 lekë për vitin 2012.

³⁷ Ndryshe nga sa subjekti i rivlerësimit, ka parashtruar në kërkesën për dorëheqje të vitit 2021, kohë në të cilin kishte filluar procesi i rivlerësimit.

14.16 Në përfundim, Komisioneri Publik, lidhur me pasuritë tokë bujqësore “Arë”, për sa më sipër analizuar, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se rrethanat e konstatuara lidhur me këto pasuri e vendosin subjektin e rivlerësimit para një deklarimi të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

15. *Likuiditete cash*

15.1 Në D-Vett., personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: (i) *Likuiditete cash 10.000 euro, (shuma e mbetur pas vjedhjes së banesës në datën **.8.2016). Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004. Pjesa takuese 100%. (ii) Likuiditet cash në shumën 52.000 euro dhe 100.000 lekë, vjedhur në datën **.8.2016. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004.*

15.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2009, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *Kursime dhe kambiale. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali. Vlera 70,000 euro. Pjesa takuese 100%.*

15.3 Në DV-2013 deklarohet: *Pakësuar kursimet në vlerën 8,000 euro.*

15.4 Në DV-2014 deklarohet: *Kursime nga pagat (gjendje cash) 600,000 lekë. Pjesa takuese 50%.*

15.5 Në DV-2016 deklarohet: *Pakësuar likuiditeti cash (pas vjedhjes së banesës në datën **.08.2016). Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004. Vlera 52,000 euro. Pjesa takuese 100%.*

15.6 ILDKPKI-ja³⁸ lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me likuiditetin cash në shumën 52.000 euro, me burim financiar nga aktiviteti privat dhe shitja e restorantit në Itali, deklaruar nga bashkëshorti i subjektit.*

15.7 Komisioni për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të këtyre kursimeve cash ka kryer analizën financiare paraprake, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pamundësi financiare në vlerën – 13.134.814 lekë, për krijimin e gjendjes së kursimeve cash, si dhe të pasurive të tjera të të deklaruara në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2009,³⁹ ku përfshihen dhe 2 huadhënie, përkatësisht, hua në shumën 17.000 euro dhënë shtetasve ***. ***, dhe huaja në shumën 3 milionë lekë dhënë shtetasit ***.***.

15.8 Në vijim, Komisioni pasi vëren se këto kursime e kanë burimin nga të ardhura të krijuara para martesës së subjektit si dhe përpara fillimit të deklarimit (rikthimit në detyrë) të

³⁸ Referohuni aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjonit të ILDKPKI - së nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

³⁹ Rezultoni se në analizën e Komisionit janë përfshirë ndër të tjera: (i) Të ardhurat e subjektit nga avokatia për periudhën 2007-2009 në vlerë totale 4,578,160 lekë; (ii) Të ardhurat e fituara nga bashkëshorti si shef kuzhine gjatë periudhës 2005-2011 në vlerën 3,160,000 lekë; (iii) Të ardhura të bashkëshortit nga emigracioni nga marrëdhënia e punësimit në vlerën 4,434,170 lekë. Gjithashtu në analizën financiare të mësipërme janë përfshirë ndër të tjera edhe dy huat e deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur dhënë shtetasve ***. ***, në shumën 3.000.000 lekë dhe ***.***., në shumën 17.000 euro ose 2.094.103 lekë.

saj dhe se kjo shumë në Deklaratën “Vetting” është vetëm 10.000 euro (pasi shuma 52.000 euro është vjedhur në vitin 2016), i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 pasi ka konstatuar se: (i) *Subjekti ka mospërputhje të vlerës së deklaruar në DIPP 2016 prej 884.580 lekë me vlerën e deklaruar në deklaratën Vetting prej 10.000 euro ose 1.329.500 lekë.* (ii) *Duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë patur pamundësi financiare për të krijuar gjendjen e kursimeve cash prej 70.000 euro (ose rreth 9.601.900 Lekë) në vlerën totale të tyre, pra (-9.601.900 Lekë), të deklaruar në DPF 2009.*

15.9 Në përfundim, Komisioni pasi ka shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës ndër të tjera ka rishikuar analizën financiare duke llogaritur marzhin e fitimit nga aktiviteti i avokatisë së subjektit në masën 90%⁴⁰, ka rishikuar të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si ristorator për periudhën 2005-2011 si dhe arsyetuar se: *[...] në vlerësim të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se të ardhurat e bashkëshortit të deklaruar nga puna si shef kuzhine në tri subjektet të përfshihet në analizën financiare ... në analizën financiare të burimit të ligjshëm 70,000 euro në vitin 2009 janë të ardhurat nga shitja e aktivitetit të bashkëshortit në Itali, të cilat janë analizuar në pikën 29.6 të vendimit dhe që do të vlerësohen në tërësi lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë. Janë pikërisht këto të ardhura që pasqyrojnë pamjaftueshmërinë në analizën financiare, në vlerën totale të likuiditetit [...]*⁴¹.

Lidhur me rezultatet e analizës financiare, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim, duke realizuar një analizë financiare, ku të ardhurat e bashkëshortit nga shitja e shoqërisë “***”, pavarësisht se nuk janë konsideruar nga trupi gjyqësor si të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke qenë se ato nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, **analiza financiare e subjektit rezulton me një bilanc për periudhën shkurt 2009 – 2016, me vlerë negative -152,147 lekë. Ndërsa, analiza përpara fillimit të deklarimit të vitit 2009 rezulton me pamundësi financiare në vlerën -11,902,960 lekë [...]***⁴².

Në përfundim ka vlerësuar se *[...] subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

15.10 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni në vendimin e tij, ndan qëndrim të ndryshëm dhe vlerëson se pamjaftueshmëria e rezultuar nga analiza financiare, bën që subjekti të mos arrijë një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për efekt të këtij procesi. Komisioneri Publik vlerëson se, subjekti i rivlerësimit dhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuar nga Komisioni.

⁴⁰ Referuar arsyetimit të Komisionit në f. 28, prg. 38.5 të vendimit citohet e ardhura nga avokatia në shumën 8.848.980 lekë, ndërsa në analizën financiare përfundimtare në f. 37 të vendimit duket se është përfshirë në zërin të ardhura si e ardhura nga avokatia shuma 4.876.680 lekë.

⁴¹ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 30 të vendimit.

⁴² Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 33-36 të vendimit dhe analizës financiare përfundimtare të paraqitur në f. 37 të vendimit.

15.10.1 Sikurse është arsyetuar dhe më sipër në këtë ankim, në trajtimin e pasurisë *apartament me sip. 111.6 m²*, rezulton se znj. Mirela Mishgjoni ka mbajtur funksionin e gjyqtares dhe ndihmës gjyqtares gjatë periudhës 1995-2002 dhe megjithëse subjekti ka lidhur martesë ligjore në vitin 2008, ajo ka bashkëjetuar me z. *** ** që prej vitit 2005. Sa më sipër, ndryshe nga sa konstaton Komisioni rezulton se pasuritë e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës dorëzuar në ILDKPKI, në datën **.3.2009, janë krijuar gjatë bashkëjetesës së subjektit me personin e lidhur ndërkohë që subjekti kishte ushtruar për disa vite funksionin e gjyqtares.

15.11 Në përfundim, sikurse arsyetuar gjerësisht lidhur me burimet për krijimin e pasurisë *apartament me sipërfaqe 111.6 m²*, Komisioneri Publik vlerëson se nuk duhen konsideruar si burime të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit: (i) Të ardhurat e personit të lidhur nga shitja e shoqërisë “****” në Itali; (ii) Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si ristorator për periudhën 2005–2011; (iii) Të ardhurat nga marrëveshja nr.*** datë **.2.1997 për shitjen e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, Vlorë, pasi këto të ardhura nuk përmbushin kriteret e nenin D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu nuk duhen përfshirë në analizë të ardhurat e personit të lidhur nga paga në emigracion në Itali pasi sikurse trajtuar më lart nuk rezulton mundësi kursimi nga këto të ardhura.

15.12 Komisioneri Publik, vëren se pamjaftueshmëria e konstatuar nga vetë Komisioni, por e konsideruar pa efekt penalizues në këtë proces, afekton jo vetëm kursimet *cash* por edhe pasuritë e tjera të krijuara deri në datën **.2.2009, përfshirë këtu edhe dy huat në shumën 17.000 euro dhe 3.000.000 lekë, deklaruar si burime krijime për pasuritë e krijuara nga subjekti pas vitit 2009.

15.13 Sa më sipër, Komisioneri Publik, vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe ndodhet në kushtet e nenit 61 pika 3 të ligjit nr.84/2016.

16. Lidhur me huan në vlerën 17.000 euro, dhënë shtetases **.*,., deklaruar si burim krijimi i pasurinë “Automjet tip Daimler Chrysler C270 CDI”**

16.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: Autoveturë *Daimler Chrysler, C270 CDI*, blerë më **.6.2009, 9.100 euro, detyrimi doganor 479.000 lekë. *Burimi i krijimit*: Me të ardhura të kursyera gjatë viteve, të cilat i janë dhënë hua shtetases *** ** në vitin 2008 dhe kthyer prej saj në vitin 2009. Pjesa takuese: 50%.

16.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI në datë **.3.2009 subjekti ka deklaruar: “*Dhënë hua një personi fizik në ** korrik 2008. Vlera: 17.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si avokate dhe aktiviteti ristorator i bashkëshortit*”. Ndërsa në rubrikën “Të dhënat konfidenciale” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: “*Dhënë hua motrës *** ** datë **.7.2008*”.

16.3 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë “Automjet Daimler Chrysler” por pa deklaruar burimin e krijimit. Në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar as kthimin e huas nga znj. *** **.

16.4 Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës ** shkurt 2015, në lidhje me këtë hua, subjekti ka deklaruar: [...] *Kam dokument ligjor që provon huadhënien, likuiditet i dhënë në vitin 2008, të cilin po e paraqes. Lekët i mora në vitin 2009 dhe i kam përdorur për blerje*

automjeti në atë vit dhe nevoja të ndryshme. Do të paraqes edhe deklaratë noteriale që vërteton shlyerjen e detyrimit [...].

16.5 ILKDPKI-ja në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Mirela Mishgjoni, datë **.3.2021, lidhur me këtë pasuri ka konstatuar: (i) *Mosdeklarim i kthimit të huas në shumën 17.000 euro, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2009, e cila deklarohet si burim për blerjen e automjetit; (ii) Mungesë dokumentacioni justifikues lidhur me burimin financiar për krijimin e shumës 17.000 euro, në v.2008.*

16.6 Në dosje të Komisionit, ndër të tjera, janë administruar: (i) Kontrata në gjuhën gjermane, e datës **.6.2009 sipas së cilës subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë blerë automjetin “tip Mercedes C270” për shumën 9.100 euro; (ii) mandatpagesa e datës **.6.2009 për pagesën e detyrimeve doganore në vlerën 477.527 lekë; (iii) Deklarata noteriale me nr. ***/***/*, datë **.3.2009, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe znj. *** ***, të cilat deklarojnë se znj. Mirela Mishgjoni i ka dhënë motrës së saj hua pa interes në shumën prej 17.000 euro më datë **.7.2008, me qëllim rikonstruksionin e banesës së kësaj të fundit; (iv) Deklarata noteriale nr. ***/***/*, datë **.3.2015, nënshkruar nga subjekti dhe shtetasja ***.***., ku deklarohet se shuma 17.000 euro është likuiduar në qershor të vitit 2009 nga shtetasja ***.***.

16.7 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016 i ka kaluar subjektit barrën e provës për këtë pasuri, pasi ka konstatuar se: (i) *Duket se subjekti nuk ka patur mundësi të japi hua në dt. **.7.2008, motrës së saj në vlerën 17.000 euro me të ardhura të ligjshme. Duke rezultuar me vlerë negative në shumën totale të huas prej 17.000 euro ose 2.094.103 lekë; (ii) Duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk ka pasur mundësi për blerjen me të burime të ligjshme të automjetit me vlerë 12.592 euro (9.100 euro + 479.000 lekë), pasi nuk u provua ligjshmëria e burimit të tij.*

16.8 Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës ndër të tjera ka arritur në përfundimin se: [...] *lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie, merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi janë krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, janë të ardhura të provuara nëpërmjet akteve noteriale, nuk janë produkt i një veprimtarie të paligjshme, si dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të përdorimit të të ardhurave për të cilat nuk ishin shlyer detyrimet tatimore. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë [...].*

16.9 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së datë 28.6.2024, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me ligjshmërinë e huas në shumën 17.000 euro, deklaruar si burim krijimi për pasurinë “Automjet tip Daimler Chrysler C270 CDI”, për sa vijon:

16.10 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DV-2009, kthimin e huas nga motra e saj në shumën 17.000 euro dhe as burimin e krijimit të pasurisë automjet.

16.11 Sikurse trajtuar dhe arsyetuar në mënyrë të detajuar më sipër në këtë ankim ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara para vitit 2009 përfshirë këtu dhe kursimin e shumës 17.000 euro të deklaruar si të dhënë hua shtetases *** ***.

16.12 Referuar deklaratës noteriale të datës **.3.2015, nënshkruar nga subjekti dhe motra e saj, ku deklarohet kthimi i huas në shumën 17.000 euro në qershor të vitit 2009, rezulton se kjo deklaratë është hartuar disa ditë mbas mbajtjes së procesverbalit pranë ILDKPKI-së (**.2.2015) dhe 6 vite pas kthimit të pretenduar të huas, duke krijuar bindjen se është hartuar gjatë kontrollit nga ILDKPKI-ja, për të provuar se subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë “Automjet tip Daimler C270” për shumën rreth 12.592 euro (9.100 euro+479.000 lekë) në **.6.2009.

16.13 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shumën 17.000 euro dhënë hua shtetases *** *** dhe si rezultat ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë automjet tip “Daimler Chrysler C270 CDI”, që deklarohet me burim krijimi kthimin e kësaj huaje.

Çështje të tjera

17. Apartament banimi me sip. 134.5 m², ndodhur në Tiranë

17.1 Në DV-2020, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti nr.***/** datë **.6.2020, me sipërfaqe ndërtimi 134.5 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 22.2 m² në Tiranë rr. “*** ***”. Vlera :161.401 euro. Pjesa takuese: 50%. Në funksion të të pagesës së këtij apartamenti kemi shlyer në datën **.6.2020, shumën 13.667.500 lekë (konvertimi i shumës 110.000 euro) për pagesën e së cilës është përdorur depozita e kursimit pranë *** Bank në shumën 9.765.339 lekë plus shuma 747.529 lekë (që janë interesa bankare të kësaj depozite gjatë tre viteve) plus shuma 608.553 lekë (që janë konvertimi në lekë i 4.927,56 euro të ndodhura në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit *** *** pranë *** Bank) plus shuma 2.170.000 lekë (transferuar nga llogaria ime e pagës pranë *** Bank plus shuma 376.100 lekë (të transferuara nga llogaria në lekë e PF “*** ***” pranë *** bank). Në datën **.12.2020, kemi shlyer shumën 20.000 euro për pagesën e së cilës janë përdorur të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i Personit Fizik “*** ***”. Në datë **.12.2020 kemi shlyer shumën 6.000 euro për pagesën e të cilës janë përdorur të ardhurat nga paga ime.*

17.2 Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga dorëzimi i Deklaratës “Vetting”, subjekti dhe bashkëshorti kanë lidhur me shoqërinë “****”, sh.p.k. dhe Person Fizik “***.***.”, një kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, nr.***/**, datë **.06.2020. Sipërfaqja e apartamentit të prenotuar është 134,5m², sipërfaqe ndërtimi dhe 22,2m², sipërfaqe e përbashkët. Vlera e apartamentit të prenotuar është përcaktuar 161.401 euro.

17.3 Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, vëren se Komisioni ka përmendur shkarazi këtë pasuri në rezultatet e hetimit dhe në vendimin e tij (referohuni prgr.30.8), pa u ndalur në verifikimin e shumave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie.

17.4 *Komisioneri Publik* bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e vettingut si dhe jurisprudencën e Kolegjit, mban në konsideratë se analiza e shpenzimeve të kryera pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting”, mund të ketë relevancë për procesin e rivlerësimit në rrethana specifike. Kolegji ka interpretuar në jurisprudencën e tij se, *nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016* (pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting”), *me të ardhura të padeklaruar apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të Deklaratës Vetting, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni [ose Kolegji] në kushtet kur krijohet dyshimi për deklaram të pasaktë dhe të pavërtetë në Deklaratën Vetting*⁴³.

17.5 Në rastin konkret, pjesë e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe ndërtimi 134.5 m², ndodhur në Tiranë, është dhe huaja e kthyer nga babai i bashkëshortit në vitin 2016 (rreth 3.000.000 lekë), deklaruar si huadhënie në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, për të cilën sikurse trajtuar më sipër, Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri.

18. Shoqata “*”**

18.1 Komisioni ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, informacion të dokumentuar nga Regjistri Noterial Shqiptar, për veprime të kryera që kanë për objekt pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Nga informacioni i administruar nga Ministria e Drejtësisë, me shkresën ***/* prot., datë **.03.2021, Komisioni ka administruar nga noteri publik ***. ***. me shkresë datë **.8.2023, dokumentin *vërtetim nënshkrim* të aktit të themelimit dhe vendimit të asamblesë të shoqatës ***. Një ndër nënshkruesit e këtyre akteve ishte dhe bashkëshorti i subjektit.

18.2 Komisioni i ka kërkuar informacion Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Përgjithshëm Tiranë, e cila me shkresën nr.*/* prot., datë **.10.2023, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kësaj shoqate.

18.3 Nga aktet ka rezultuar se shoqata “***”, është regjistruar me vendim nr. ***, datë **.1.2014, me drejtor ekzekutiv znj. ***. ***. (*motra e subjektit të rivlerësimit*), dhe me objekt veprimtarie zhvillimin e cilësisë në sistemin arsimor shkencor, për formimin e rinisë në universitet, për sensibilizimin, rehabilitimin, integrimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë për çështje të ndryshme sociale dhe arsimore. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga aktet në dosje rezulton në cilësinë e anëtarit themelues.

18.4 Komisioni, sa më lart trajtuar ka arritur në përfundimin se nuk rezultuan problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit për këto konstatime, dhe nuk duket të ketë administruar akte të tjera në drejtim të vlerësimit të aktivitetit të kësaj organizate.

19. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; dhe (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri

⁴³ Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2021, prg. 26.3.

Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 dhe 5 e aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

V. Kërkimi i ankimit

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;

21. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim, në konsideratë dhe të rekomandimit të ONM-së;

22. Bazuar në nenin Ç, D, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3, 5, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 754, datë 5.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Mishgjoni.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

I. Introduction

The assessee Mirela Mishgjoni, serving as a judge at the Vlora District Court, has undergone the re-evaluation process by the Independent Qualification Commission (hereinafter referred to as “IQC”) in accordance with Article 179/b, par. 3 of the Constitution and the provisions of the Vetting Law.

The IQC conducted its investigation based on three criteria: assets, background, and proficiency. After reviewing reports from auxiliary bodies and considering evidence obtained through the investigation process and submitted by the assessee, the IQC’s Adjudication Panel concluded the investigation. They then notified the assessee of their findings, shifted the burden of proof on certain issues, and requested explanations.

Hearing was held on 03.04.2024, and following deliberation as per Article 55, paragraph 5 of the Vetting Law, the Adjudication Panel, with a majority vote, decided to confirm the assessee in duty pursuant to Article 59 Vetting Law.

The undersigned International Observers (hereinafter the “IOs”), having reviewed the case file and the results of the public hearing, believe that the evidence presented during the investigation justifies a review of the case by the Appeal Chamber.

II. Grounds for recommendation

Several issues were not properly assessed by the IQC. The decision does not appear to be based entirely on the available evidence. It deviates from the standards typically held by the IQC in its current practice, and from the principles and guidelines established by the Special Appeal Chamber (hereinafter “AC”).

It is the IOs’ opinion that the assessee failed to adequately address the burden of proof regarding certain crucial findings resulting from the investigation. Furthermore, it is noted that the assessee’s attempts to rebut these findings were predominantly based on narratives lacking supporting evidence. Despite this, IQC accepted all her explanations and decided to confirm the assessee in duty with a majority vote.

Therefore, the IOs recommend that the Public Commissioners (hereinafter PCs) file an appeal against the IQC’s decision no. 754, dated 05.04.2024 which confirmed Mirela Mishgjoni in duty.

The IOs believe that a proper assessment of the evidence presented in the case, along with correct application of the relevant legal framework, would provide grounds for the AC to modify the IQC’s decision pursuant to article 66, para. 1.c of the Vetting Law.

Thus, the IOs request a judicial review of the entire case, particularly focusing on the following issues:

1. Assets assessment

It is our opinion that the assessee did not rebut certain investigative findings and the IQC did not provide clarity as to why, given the insufficient rebuttal, they reached a decision for a confirmation in office. The latter indicates a misinterpretation of the available evidence on crucial matters and insufficient reasoning of the decision.

1. **Apartment¹** with an area of 111.6 m², (120.7 m²), Lagje [Quarter] *** ***, Vlore, purchased on 3.5.2006. Price EUR 60.000, share 50%. **Source of creation:** Income from her spouse's activity as a chef, and the activity of the declarant [assessee] as lawyer.

On **05.2006, the assessee signed a down payment contract Col. no. ***/** for the future purchase of an apartment, measuring 120.7m², located in Lagje *** ***, Vlore, with price EUR 60,000.

The above amount was paid in instalments as follows: the first instalment EUR 25,000 was paid through the *** Bank on **12.2005, the second instalment EUR 10,000 was paid through the *** Bank on**5.2006, the third instalment EUR 19,000 was paid through the *** Bank on **8.2006 and the fourth instalment EUR 4,864 was paid to *** ***, Ltd. company, with mandate no. ** on *.6.2007. The remaining difference in the amount EUR 1,136 was paid in small instalments for carrying out works.

Regarding the financial capability of the assessee to pay for the apartment, the IQC in the results of the investigation concluded, that the assessee and her spouse lacked a total of ALL 3,626,738.

In view of the above the undersigned IO-s are of the opinion that the investigation of the IQC and the methodology of the financial analysis need to be subjected to the review of the SAC with respect to the issues identified below:

- a) The assessment should be conducted by taking into consideration that the assessee had worked as a judge from 1995 to 2002. On **.07.2002 she had been dismissed by decision of the HCJ – a decision she legally challenged. On **.02.2009, as a result of her litigation, the HCJ decision was repealed, and she was reinstated as judge.
- b) The payments made for the apartment in Vlora in December 2005 in advance of the conclusion of the off-plan contract were not verified by the IQC. **Although the assessee married her spouse in 2008 the IQC should have considered that the assessee herself signed the off-plan contract in December 2005 and she made all related payments.**

¹ The assessee attached to the declaration: Certificate of Ownership and property card dated *.11.2013; Sale/Purchase Contract rep. no. ***, col. no. ***/*, dated *.10.2013; Down Payment Agreement rep.no. **, col. no. **, dated *.5.2006.

- c) The IQC wrongfully considers the spouse's income from sale of the business in Italy as a source for the purchase of the apartment in Vlora even though in the vetting declaration the assessee had declared as source only "*income from salary in Italy*".

Apart from the fact that this income was never declared as a source for the creation of the asset, taxes for the income gained from the sale were paid only starting from **11.2023 – belated and only for vetting purposes.

Even if one would be inclined to consider the respective income as a source, there is no evidence for any of the claimed financial transactions actually having occurred, and only the first instalment of the promissory notes claimed to have been paid in 2006 could be considered as timely available financial source for the apartment.

The IQC's calculation of the spouse's income from work in Italy is inconsistent and not based on available evidence.

The IQC has not in detail explained its way of calculating the saving capacity of the spouse. In para. 30.1. the Commission wrongfully mentions that: "*...the lawful income according to the Italian social insurance institute (INSP) for the period 1996 - 2005, amounts to EUR 67,319 in total.*" It refers to table no. 5 of the Investigation Results. However, in this table the calculation of the INSP data (1st row) results in a sum of only EUR 36,822.

- d) The IQC then calculates the spouse's savings capacity for the period of 1996 to May 2005 with EUR 36,185. According to the above-mentioned table no. 5, the IQC reached this result by selecting the largest amount from two unrelated and distinct sets of data: from the INSP and from the Italian Tax Authority. The last-mentioned set of data provided a gross income, without deduction for mandatory social contributions and should not have been considered for calculating a net income. The IQC's calculation method is wrongful. If the calculation is based consistently on the INSP data, the result is a total minus, and no income can be considered as source for the purchase of the apartment in 2005.
- e) **The IQC reasons that the assessee and her spouse had divided family income and living expenses because they were married only on *.09.2008. This is contradicted by the assessee's answer in the standard questionnaire where she stated: "*From 2005 onwards I lived with my husband *** ** Living expenses were a joint contribution.*" and by notarial declaration of * 11.2014 of Notary *** ** , in which both stated and signed that "*they were married in 2008 but began to co-habit in 2005*".**

The IOs consider that neither the income from the spouse's sale of the ' *** ' company in Italy nor any salary income from his employment there should be considered in the financial analysis.

2. Agricultural land of total 15,560 m², at *** Vlorë purchased by the spouse of the assessee in the years 2010 and 2012 where the sellers are all represented by Mr. *** *** (the husband of assessee's sister). The total value of the land **as per minimum fiscal price** was evaluated before the selling with **ALL 6,367,356** but the husband of the assessee purchased them for only **ALL 1,061,600**.

• *Agricultural land, etc. 4,560 m², in *** Vlorë, purchased with contract no.*** / *** dated **4.2012. Value 273,600 ALL,*

• *Agricultural land, etc. 4,300 m², in *** Vlorë, purchased with contract no.*** / *** dated **4.2012. Value 258,000 ALL.*

• *Agricultural land etc. 1,000 m², in *** Vlorë, purchased with contract no. *** / *** dated **3.2010. Value 60,000 ALL,*

• *Agricultural land etc. 2,500 m², in *** Vlorë, purchased with contract no.*** / *** dated **3.2010. The value is 150,000 ALL, the declared taxable portion is 100% and the source of creation for these real estates is savings. "*

The IQC did not investigate the real price for which the previous owners have sold the agricultural land to Mr. *** *** who latter on sold it to the spouse of the assessee Mishgjoni.

The power of attorney issued to Mr. *** specifies that the parties have received the payment, but the value of the latter is not referred in the document.

It is unclear how these transactions were performed since there is no prove of payment provided.

IQC neither addressed the ASHK, nor received any documents from ASHK for these properties, to verify what is the value of these properties after the purchase.

IQC only relied upon the declaration of the assessee with respect to the destination of the asset. In the answers to questionnaire no.3 the assessee declared that the property is currently given to a friend of the spouse of the assessee without remuneration however, she accepted that the friend is cultivating grapes and giving to the spouse 10% of the annual produce.

The IQC did not take any steps to further investigate if any written business agreements have been drafted or that any winery is in fact developed on the land purchased by the husband of Mishgjoni.

Had the IQC calculated the price of the asset at the value provided for the fiscal purposes the assessee would have been in a negative balance for the year 2012 of ALL (-)3,001,912 and year 2010 of ALL (-)235,435, therefore the conclusions regarding these assets would have been different.

3. Regarding the financial capability of the assessee to provide EUR 17,000 to *** ** (sister of the assessee) there was no proper consideration given. The return of this loan was to demonstrate that the assessee had sufficient lawful income to purchase the vehicle in the total value of 12,592 EUR (9,100 EUR + 479,000 ALL) on * .06.2009. Instead of assessment and consideration the IQC provided a vague theoretical elaboration on the effect of the financial capacity of a related person: *[...The Commission considers that, in its evaluation, regarding the consequences of the negative difference in the creation of this asset, it takes into consideration the fact that the source of its creation is the income of the related person, which, although it does not pass the test of the article D point 3 of the Constitution, cannot be penalized in the process of revaluation of the subject, since they were created long before they started married life, they are proven income through notarial acts, they are not the product of an illegal activity as well as the subject was not aware of the use of untaxed income. Consequently, this possibility will be assessed in the overall assessment of the property...]*. It should be mentioned that during the investigation and for the period 1995-2008 it was established that the assessee had a negative result of ALL 11,900,000 and this comes to say that she was not able to provide this loan in the first place.
4. Regarding the purchase of the apartment 134.5 sqm in 2020 in Tirana for a total of EUR 161,401. The assessee provided documents (contract and payments slip) with the replies of the 3rd questionnaire in which she explained that the first and second instalments were paid in **.06.2020 of EUR 110,000, **.12.2020 of 20,000 and EUR 16,400 through 2022 in small instalments, so total EUR 146,400 was paid. However, the source of these amounts was not investigated at all. It is mentioned en passant.
5. According to the documents on file, the assessee's spouse appears to be in the capacity of one of the founders of a non-profit organization named " *** ". No issues were established in these findings with regard to the re-evaluation process. According to the Articles of Association of the organization, Mr. *** ** is also a member of the Bord of directors of the organization. As per Article 19 and 23 of the Articles of Association, these are both governing bodies of *** .
The IQC did not take steps to investigate and assess the activity of this organization.

III. Conclusions

In light of these considerations, a proper evaluation of all the elements listed above would likely lead to a conclusion different from the one reached by the IQC majority which confirmed the assessee in office.

Therefore, the IOs recommend that the Public Commissioners file an appeal against the decision of the IQC to confirm the assessee in office.

Respectfully submitted,



International Observer

International Observer

International Observer